

**Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët
për vitin akademik 2019/2020
Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm**

1. Hyrja

Në këtë raport janë paraqitur vlerësimet e programit dhe të stafit akademik nga studentët e programit: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm.

Vlerësimi i stafit akademik është realizuar, gjithashtu, përmes pyëtësorit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU). Për dallim nga vlerësimi i programit, i cili realizohet një herë brenda vitit akademik, vlerësimi i stafit akademik realizohet në [do semestër. Pyetjet, edhe të ky vlerësim, janë të ndërtuara në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk pajtohem fare; 2 - Nuk pajtohem; 3 - Neutral; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

**1.1 Raporti i komulativ i vlerësimit të stafit akademik për
programin MSc. Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm për vitin
akademik 2019/2020**

Stafi akademik i programit Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm është vlerësuar në çdo semestër nga studentët dhe janë paraqitur rezultatet komulative të vlerësimit për secilin komponent në tabelën nr. 1. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të stafit akademik, vërejmë se të gjitha komponentet e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, ose më saktësisht mbi 4. Megjithatë, menaxhmenti i këtij Fakulteti, duhet të mbetet i përkushtuar që të përmirësojë edhe më tutje kënaqshmërinë e studentëve me stafin akademik. Marrë në përgjithësi, kënaqshmëria e studentëve me stafin akademik për vitin 2019/2020, është 90.83% ose 4.54.

Tabela nr.2 Vlerësimi i stafit akademik

Pyetjet	Mesatarja
Syllabusi i lëndës, i cili përfshinë përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit, më është prezantuar në mënyrë të detajuar në fillim të semestrit	4,55
Vijimi i mësimdhënësit gjatë semestrit ka qenë i rregullt dhe në kohë	4,54
Mësimdhënësi ka ardhur gjithmonë i përgatitur në mësim	4,37
Aktivitetet gjatë semestrit kanë krijuar mundësi që studentët të angazhohen në diskutime, aktivitete kreative, si dhe është inkurajuar ndërveprimi i studentëve (puna në grupe, dyshe, etj).	4,44
Mësimdhënësi ka qenë në dispozicion të studentëve për konsultime, në Universitet, apo online	4,42
Mësimdhënësi i inkurajon mendimet e ndryshme të studentëve dhe i respekton ato	4,41
Materialet e ofruara për studime gjatë semestrit ishin të përshtatshme për fitimin e njohurive dhe të shkathtësive të parapara për këtë lëndë	4,41
Materialet e ofruara nga mësimdhënësi janë publikuar me kohë në SMU, Teams, apo në Moodle	4,47
Studentët kanë qenë të informuar paraprakisht për kriteret e vlerësimit të provimit/punimeve, ose të punës së tyre, në përgjithësi	4,48
Vlerësimi i punës së studentëve për lëndën gjatë semestrit është bërë sipas syllabusit të lëndës	4,49
Nëse mësimi është mbajtur në klasë, mjetet e konkretizimit (markerat, projektori, tabela, etj) dhe hapësira e mësimit kanë qenë në dispozicion dhe janë shfrytëzuar mirë nga mësimdhënësi	4,49
Mësimdhënësi ka përdorur platformën virtuale të mësimit Microsoft Teams dhe mundësitë e saj me lehtësi	4,54
Lënda ka qenë e dobishme për studentët	4,51